



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	<b>Drejtoria e Bujqësisë</b>
Periudha raportuese	Maj 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fexhri Hyseni

#### ***1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.***

Duke u bazuar në planprogramin e punës në kuadër të Drejtorisë, brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me grupet e interesit-fermerët, shoqatat e ndryshme, institucione të ndryshme etj.

Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në sektorin e bujqësisë që kanë qenë të planifikuara sipas programit të punës.

#### ***2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj.***

- Monitorimi i punëve për strategjinë afatmesme dhe afatshkurtër në Drejtorinë e Bujqësisë;
- Monitorimi i punëve për zhvillimin e sistemit të digjitalizimit-platformë online;
- Vizita tek fermerët përfitues të grandeve nga Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me RESI-n austriak;
- Planifikohen takime me fermerë dhe grupe të interesit;
- Planifikohet të implementohet punëtoria për krijimin e Qendrës Komunale për Zhvillim (QKZ);
- Takime me përfaqësues të KFOR-it rreth menaxhimit të pyjeve dhe vendgjuetive;
- Përzgjedhja e përfituesit të tenderit “Vaksinimi i gjedheve, kafshëve të imëta dhe qenve me pronarë”;

- Planifikohen takime me fermerë, shoqata dhe grupe të interesit.
- Vizita tek fermerët e komunës së Prishtinës;
- Është bërë hapja e thirrjeve për aplikim për të gjitha subvencionet e parapara për këtë vit në Sektorin e bujqësisë, si në vazhdim:
  - Thirrja për aplikim për përkrahje në blegtori,
  - Thirrja për aplikim për përkrahje në bletari,
  - Thirrja për aplikim për përkrahje në perimekulturë – sistemi i ngrohjes në serra,
  - Thirrja për aplikim për përkrahje në prodhimtarinë organike,
  - Thirrja për aplikim për përkrahjen e shoqatave të cilat operojnë në territorin e komunës së Prishtinës,
  - Thirrja për aplikim për përkrahjen e fermerëve për certifikim organik.

**3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.***

- Deri më tani kemi zhvilluar mbi 10 vizita në terren, ku kemi parë për së afërmi aktivitetet që i zhvillojnë fermerët përfitues nga Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me organizatën austriake RESI-ADA;
- Kemi mbajtur 33 takime me fermerë të ndryshëm;
- Është mbajtur punëtorja për krijimin e Qendrës Komunale për Zhvillim (QKZ) në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë;
- Kemi mbajtur takime me përfaqësues të KFOR-it rreth menaxhimit të pyjeve dhe vendgjutive;
- Jemi në pritje të përzgjedhjes së përfituesit të tenderit “Vaksinimi i gjedheve, kafshëve të imëta dhe qenve me pronarë”.
- Kemi mbajtur takime me përfaqësues nga Shoqatat e Bimëve Aromatike, Gjuetarëve, Shpeztarëve dhe Peshkatarëve;
- Gjithsejtë kemi vizituar 13 fermerë të komunës së Prishtinës gjatë këtij muaji.

**4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:***

- Vazhdon tutje aplikimi i fermerëve për subvencione dhe grande në Drejtorinë e Bujqësisë;
- Jemi duke realizuar vizita në sektorët e ndryshme të Drejtorisë së Bujqësisë;

- Është duke vazhduar monitorimi i punëve për strategjinë afatmesme dhe afat shkurtër në Drejtorinë e Bujqësisë;
- Është duke u zhvilluar procesi i monitorimit të punëve për zhvillimin e sistemit të digjitalizimit-platformë online për Drejtorinë e Bujqësisë.

#### ***4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese***

- Nuk janë planifikuar për këtë periudhë

#### ***4.1.3 Takimet me palë***

- 33 takime.

### ***5. Takimet me institucione të tjera***

- Nuk ka pasur.

### ***6. Diskutime publike/Takimet me qytetarë***

- Nuk ka pasur.

#### ***6.1.1 Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare***

- Nuk ka pasur.

#### ***6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër***

### ***7. Takime të tjera***

- Nuk ka pasur.

### **8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.**

- Si Drejtori e Bujqësisë, kemi evidentuar vështirësi me të cilat ballafaqohen fermerët për nxjerrjen e lejeve të ndërtimit në Drejtorin e Urbanizimit për ndërtimin e stallave.

**9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të Drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.**

***10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:***

- Përgatitjet për procesin e korrje-shirjeve 2018;
- Pjesëmarrje në punëtorinë “Finalizimi i strategjisë afatmesme për bujqësi dhe zhvillim rural në komunën e Prishtinës”.
- Përditësimi i të dhënave në sektorin e bujqësisë për zhvillimin e sistemit të digjitalizimit-platformë online;
- Vizita tek fermerët që ishin përfitues të granteve nga Komuna e Prishtinës;
- Planifikohen takime me fermerë dhe grupe të interesit;
- Pritet të zgjedhet përfituesi i tenderit “Vaksinimi i gjedheve, kafshëve të imëta dhe qenve me pronarë”;
- Vlerësimi i aplikacioneve për subvencione dhe grante në sektorin e bujqësisë.

***11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.***